 Villai e muri automobilin nga garazhi nē vend
 tim.
 Çka mori villai nga garazhi nē vend tānd?
 Villai mori automobilin nga garazhi nē vend tim.
- A do tē flitni ju n'emën tē Shoqnis Koha?
 Po, unë do tē flas n'emën tē Shoqnis Koha.
 N'emën tē kujt do tē flitni ju?
 Unë do tē flas n'emën tē Shoqnis Koha.
 A do tē flasi doktori n'emën tē spitalit?
 Po, doktori do tē flasi n'emën tē spitalit.
 Çka do tē bâjë doktori n'emën tē spitalit?
 Doktori do tē flasi n'emën tē spitalit.
 A do t'a falënderoni ju n'emën tonë?
 Po, unë do t'a falënderoj n'emën tuej.
 N'emën tē kujt do t'a falënderoni?
 Do t'a falënderoj n'emën tuej.

LESSON 53

A âsht dërgue ky peshqesh n'emén tē tē gjithëve?
Po, ky peshqesh âsht dërgue n'emén tē tē gjithëve.

N'emén tē kujt âsht dërgue ky peshqesh?
Ky peshqesh âsht dërgue n'emén tē tē gjithëve.

A i a dërgove plaçkat n'emén tē vllait?
Po, i a dërgova plaçkat n'emén tē vllait.

N'emén tē kujt i a dërgove plaçkat?
I a dërgova plaçkat n'emén tē vllait.

A âsht llampa nē mes tē dhomës?
Po, llampa âsht nē mes tē dhomës.

Ku âsht llampa?
Liampa âsht nē mes tē dhomës.

A âsht saksija me lule nē mes tē tryezës?
Po, saksija me lule âsht nē mes tē tryezës.

Ku âsht saksija me lule?
Saksija me lule âsht nē mes tē tryezës.

c. A âsht e madhe kjo shtëpi pér né?

Po, kjo shtëpi âsht e madhe pér jú.

Pér kē âsht e madhe kjo shtëpi?

Kjo shtëpi âsht e madhe pér né.

Pér kē âsht e madhe kjo shtëpi?

Kjo shtëpi âsht e madhe pér atë.
(mue, né, ju, ata)

Cila tryezë âsht e vogël pér pesë njerëz?

Kjo tryezë âsht e vogël pér pesë njerëz.

Qysh âsht kjo tryezë pér pesë njerëz?

Kjo tryezë âsht e vogël pér pesë njerëz.

A do tē bléj nji shishe raki edhe pér jú?

Po, jū lutem, bieni nji shishe raki edhe pér
mue.

Sa shishe raki do tē bléj pér vete?

Ju do tē bieni pér vete nji shishe raki.

Kush do tē blejë pér vete nji shishe raki?

Ju do tē bieni pér vete nji shishe raki.

A dola dje pa pallto mbasi bânte tē nxehët?

Po, dje dole pa pallto mbasi bânte tē nxehët.

Kur dola pa pallto mbasi bânte tē nxehët?

Dje dole pa pallto mbasi bânte tē nxehët.

A flasin njerzit nganjiherë pa mendue?

Po, njerzit flasin nganjiherë pa mendue.

LESSON 53

Kush flet nganjiherë pa mendue?

Njerzit flasin nganjiherë pa mendue.

A e shifni at njeri pa kapelë?

Po, e shof at njeri pa kapelë.

Cilin njeri shifni?

Shof at njeri pa kapelë.

A do të shkojshim dje në plazë më kambë?

Po, dje do të shkojshim në plazhë më kambë.

Qysh do të shkojshim dje në plazhë?

Dje do të shkojshim në plazhë më kambë.

A keni hypë ndonji herë më kalë?

Po, unë kam hypë disa herë më kalë?

Sa herë keni hypë më kalë?

Unë kam hypë disa herë më kalë.

A ju pëlqen me hypë më kalë?

Po, më pëlqen me hypë më kalë.

A janë të gjitha xhaketat ndër varëse?

Po, të gjitha xhaketat janë ndër varëse.

Ku janë të gjitha xhaketat?

Të gjitha xhaketat janë ndër varëse.

A janë të gjithë librat ndër syza?

Po, të gjithë librat janë ndër syza.

Cilët libra janë ndër syza?

Të gjithë librat janë ndër syza.

A kanë ardhë fëmijët në shtëpi?

Po, fëmijët kanë ardhë në shtëpi.

Cilët kanë ardhë në shtëpi?

Fëmijët kanë ardhë në shtëpi.

A shikova edhe nën tryezë, por nuk e gjeta.

Po, shikuet edhe nën tryezë, por nuk e gjetët.

Ku shikova, por nuk e gjeta?

Shikove edhe nën tryezë, por nuk e gjete.

A kalon lumi nën urë?

Po, lumi kalon nën urë.

Çka kalon nën urë?

Lumi kalon nën urë.

A janë të gjithë rradhoret mbi tryezë?

Po, të gjithë rradhoret janë mbi tryezë.

Ku janë të gjithë rradhoret?

Të gjithë rradhoret janë mbi tryezë.

LESSON 53

d. A ka blé Zotni Struga nji shtëpi afér shtëpis
sime?

Po, Zotni Struga ka blé nji shtëpi afér
shtëpis sime.

Afér cilës shtëpi ka blé Zotni Struga nji shtëpi?

Zotni Struga ka blé nji shtëpi afér shtëpis
sime.

A u-ulëm na afér jusl?

Po, ju u-ulët afëri nesh.

Cilët u-ulën afér jush?

Ju u-ulët afér nesh.

A u-ul ai afér meje?

Po, ai u-ul afér teje.

Afér kujt u-ul ai?

Ai u-ul afér teje.

A u-ul Agimi afér tij?

Po, Agimi u-ul afér tij.

Afér kujt u-ul Agimi?

Agimi u-ul afér tij.

A u-ul vajza afér saj?

Po, vajza u-ul afér saj.

Afér kujt u-ul vajza?

Vajza u-ul afér saj.

A u-ulët ju afér tyne?

Po, na u-ulëm afér tyne.

Afér kujt u-ulët ju?

Na u-ulëm afér tyne.

A banoni afér plazhës?

Po, banoj afér plazhës.

Ku banoni?

Banoj afér plazhës.

A banoni larg qytetit?

Po, banoj larg qytetit.

Kush banon larg qytetit?

Unë banoj larg qytetit.

A ke marrë letër prej tezes?

Po, kam marrë letër prej tezes.

Çka ke marrë prej hallës?

Kam marrë letër prej hallës.

Prej kujt keni marrë letër?

Kam marrë letër prej vilait.

LESSON 53

Çka keni marrë prej dajës?

Kam marrë letër prej dajës.

A e keni marrë ju kët libër prej meje?

Po, unë e kam marrë kët libër prej teje.

Prej kujt e keni marrë kët libër?

Unë e kam marrë kët libër prej teje.

(nesh, tyne)

A do t'a bâni ju provimin mbas meje?

Po, unë do t'a bâj provimin mbas jush.

Mbas kujt do t'a bâni provimin?

Unë do t'a bâj provimin mbas jush.

A erdhën edhe pesë vetë pérveç meje?

Po, erdhën edhe pesë vetë pérveç teje.

Edhe sa vetë erdhën pérveç meje?

Erdhën edhe pesë vetë pérveç teje.

A është automobili para shtëpisë së tij.

2. A merr vesh gjermanisht?

Po, marr vesh pak gjermanisht.

Kush merr vesh pak gjermanisht?

Unë marr vesh pak gjermanisht.

A e merr vesh kët letër?

Jo, s'e marr vesh.

Kush s'e merr vesh kët letër?

Unë s'e marr vesh kët letër.

A e more vesh ç'të thash?

Po, e mora vesh ç'më thé.

A do të këtheheni në Tiranë si sot nji muej?

Po, si sot nji muej do të këthehem në Tiranë.

Kur do të këtheheni në Tiranë?

Si sot nji muej do të këthehem në Tiranë.

Ku do të këtheheni si sot nji muej?

Si sot nji muej do të këthehem në Tiranë.

A do të vijsh me më pá si sot pesë ditë?

Po, si sot pesë ditë do të vij me të pá.

Kush do të vijë me më pá si sot pesë ditë?

Unë do të vij me të pá si sot pesë ditë..

Kur do të vijsh me më pá?

Do të vij me të pá si sot pesë ditë.

A kushton 100 lekë në ditë nji kabinë në plazhë?

Po, nji kabinë në plazhë kushton 100 lekë.

LESSON 53

Sa kushton nji kabinë në plazhë?

Nji kabinë në plazhë kushton 100 lekë në ditë.

Ku kushton nji kabinë 100 lekë në ditë?

Nji kabinë në plazhë kushton 100 lekë në ditë.

Kur udhëtoni me vaporrr, a ju zë deti?

Po, kur udhëtoj me vaporrr më zë deti.

Kë zë deti kur udhëton me vaporrr?

Mue më zë deti kur udhëtoj me vaporrr.

Kur ju zë deti?

Kur udhëtoj me vaporrr më zë deti.

A ju kanë zânë ethet ndonjiherë sivjet?

Po, sivjet më kanë zânë ethet dë herë.

Kur ju kanë zânë ethet dy herë?

Sivjet më kanë zânë ethet dy herë.

Sa herë ju kanë zânë ethet sivjet?

Sivjet më kanë zânë ethet dy herë.

A të zë kolla kur pi shumë duhan?

Po, disa herë kur pij shumë duhan më zë kolla?

Kë zë kolla disa herë kur pi shumë duhan?

Mue më zë kolla disa herë kur pij shumë duhan.

Kur të zë kolla?

Kur pij shumë duhan më zë kolla.

A ke zânë shtëpi në Rr. Grameno?

Po, kam zânë shtëpi në Rr. Grameno.

Kush ka zânë shtëpi në Rr. Grameno.

Unë kam zânë shtëpi në Rr. Grameno.

Në ç'rrugë ke zânë shtëpi?

Unë kam zânë shtëpi në Rr. Grameno.

A do të më bâni telefon kur të mrrini në Korçë?

Po, kur të mrrij në Korçë do të ju bâj telefon.

Kur do të më bâni telefon?

Kur të mrrij në Korçë do të ju bâj telefon.

Çka do të më bâni kur të mrrini në Korçë?

Kur të mrrij në Korçë do të ju bâj telefon.

A ka autobus për Berat tri herë në ditë?

Po, për Berat ka autobus tri herë në ditë.

Sa herë në ditë ka autobus për Berat?

Për Berat ka autobus tri herë në ditë.

Për ku ka autobus tri herë në ditë?

Ka autobus për Berat tri herë në ditë.

LESSON 53

A ka aeroplan për Korçë tri herë në javë?
Po, për Korçë ka aeroplan tri herë në javë.
Sa herë në javë ka aeroplan për Korçë?
Për Korçë ka aeroplan tri herë në javë.

A keni blé biletë për trenin e orës 7.15?
Po, kam blé biletë për trenin e orës 7.15.
Për cilin tren keni blé biletë?
Kam blé biletë për trenin e orës 7.15.
Çka keni blé për trenin e orës 7.15?
Kam blé biletë për trenin e orës 7:15.

A i ngarkove të gjitha plaçkat n'automobil?
Po, të gjitha plaçkat i ngarkova n'automobil.
Çka ngarkove n'automobil?
Të gjitha plaçkat i ngarkova n'automobil.
A m'a kanë ngarkue mue kët detyrë?
Po, kët detyrë t'a kanë ngarkue tý.
Kujt i a kanë ngarkue kët detyrë?
Tý t'a kanë ngarkue kët detyrë.
Çka më kanë ngarkue mue?
Tý t'a kanë ngarkue kët detyrë.

A keni rezervue dy vende në teatër?
Po, kam rezervue dy vende në teatër.
Sa vende keni rezervue në teatër?
Kam rezervue dy vende në teatër.
A keni bâ rezervim për të shkue në Shkodër me
aeroplan?
Jo, s'kam bâ rezervim për të shkue në Shkodër
me aeroplan.
Kush s'ka bâ rezervim për të shkue në Shkodër me
aeroplan?
Unë s'kam bâ rezervim për të shkue në Shkodër
me aeroplan.
Çka s'keni bâ?
S'kam bâ rezervim për të shkue në Shkodër me
aeroplan.

A i lidhim pakot para se me i dërgue me postë?
Po, i lidhim pakot para se me i dërgue me postë.
Çka lidhim para se me dërgue me postë.
Pakot i lidhim para se me i dërgue me postë.
Kur i lidhim pakot?
Para se me i dërgue me postë i lidhim pakot.

LESSON 53
PART V
READING TEXT

PJESA E PESTË
COPI LEXIMI

Tre mësja më parë, Dhori Koti bashkë me të shoqen mrijtë nga Shtetet e Bashkuarët t' Amerikës në vendlindjen e tij, në Korçë, ku po bëhesh dasma e të vllait, Todit. Mbës dasmës Dhori e kaloi kohën ndërmiq e shokë tue bâ qejf.

Dy javë para se t'i mbaronte leja shkoi n'agjencin e vaporrevet për të marrë informata mbi orarin e udhëtimit. N'agjenci i thanë se për t'u-këthye n'Amerikë mund t'udhëtonë me vaporrin italian që nisesh nga Durrësi çdo të marte ase me vaporrin shqiptar që nisesh po nga skelja e Durrësit çdo të premte. Dhori deshi t'a blente biletën për gjithë udhëtimin, d.m.th. edhe për vaporrin që e çonte nga Napoli në Nju Jork, por nëpunësi i agjencisë i tha se at gjë s'kishte mundësi t'a bante kurrsesi. Atëherë Dhori pranoi që nëpunësi t'i rezervonte një vend me telefon. Shpenzimet e rezervimit me telefon i kushtuen gjithë-sejt 45 lekë.

Mbasi Dhorin dhe të shoqen i zë deti dhe mbasi dojshin rahati gjatë udhëtimit, ata nuk deshën me udhëtue me shumë udhëtarë në klasën turistike. Përkët arësyi ai rezervoi dy biletë në klasën e parë të

LESSON 53

vaporrit. Dhori deshi t'a paguente biletën me çek, por nëpunësi nuk pranonte çek. Ai pranonte vetëm lekë ase dollarë, bankënota. Nëpunësi i agjencis nuk mundi të lidhesh menjiherë me telefon me agjencin e Napolit, prandej i tha Dhorit të këtëhehesh n'orën 4 mbasdreke po t'asaj dite për të marrë përgjegjen e rezervimit.

Kështu Dhori mori vesh pothuej gjithëçka dishronte; pagoi shpenzimet e telefonit e biletën e vaporrit nga Durrësi deri në Bari dhe doli në pazár për të bléca mali që donte me nxjerrë nga Shqipnija.

Pardje, burré e grue, u-nisën.

QUESTIONS-PYETJE

1. Nga mrrjtëن në vendlindje Dhori Koti me të shoqen?
2. Dasma e kujt po bâhesh në Korçë?
3. Ku e kaloi kohën Dhori mbas dasmës?
4. Ku shkoi dy javë para se t'i mbaronte leja?
5. Pse shkoi ai n'agjencin e vaporrevet?
6. Në çë vend donte me u-këthye Dhori me të shoqen?
7. Me çfarë mjeti mund t'udhëtojshin ata?
8. Çfarë biletë deshi të blente Dhori?

LESSON 53

9. Deri ku i çonte vaporri që nisesh nga Napoli?
10. A i a dha nëpunësi i agjencis biletën e vaporrit nga Napoli për Nju Jork.
11. Për ç'arsëye nuk i a shiti ai biletën Dhorit?
12. Çka pranoi atëherë Dhori?
13. Çka i kushtoi Dhorit gjithësejt 45 lekë?
14. Kë zë deti?
15. Cilët dojshin rahati gjatë udhëtimit?
16. Për ç'arësyen nuk deshën me udhëtue në klasën turistike?
17. Në cilën klasë nuk deshën me udhëtue ata?
18. Për cilën klasë të vaporrit rezervuen dy bileta burri e grue?
19. Me çka deshi t'ë paguente biletën Dhori?
20. Kush nuk pranonte çek?
21. Çfarë të hollash pranonte nëpunësi i agjencis?
22. Kush nuk mundi të lidhesh me telefon me agjencin e Napolit?
23. Në ç'orë t'ë asaj dite duhet të këthehesh Dhori ke nëpunësi i agjencis?
24. Pse duhet të këthehesh ai ke nëpunësi?
25. Çka mori vesh Dhori?
26. Çka pagoi ai?
27. Ku doli ai mbasi pagoi shpenzimet e telefonit e biletën nga Durrësi deri në Bari?
28. Pse doli ai në pazár?
29. Çka donte me nxjerrë Dhori nga Shqipnija?
30. Cilët u-nisën pardje?

PJESA E GJASHTË
DETÝRË SHTËPIJE

Përkëtheni shqip:

1. How much does a round trip ticket cost?
2. He should keep the dog on a leash (to leash) because it's dangerous.
3. We went fishing yesterday morning but we didn't catch a thing, because we all got seasick.
4. We had to rent a cabin on the beach, because there was no place to get undressed.
5. Can you cash this check for me please? I haven't got a single lek in my pocket.

Përkëtheni anglisht:

6. E nxorën nga puna sepse është përtac.
7. Malli që erdhi dje me vaporr ishte prishë krejt për zësy të kohës së keqe.
8. S'e mora vesh fare seç'tha; flitte me zë shumë t'ulët.
9. Më vjen shumë keq; s'mund të të ndihmoj kurrsesi.
10. Po s'erdhi përgjegja ndër këto ditë, do të shkoj vetë në Tirane për të marrë vesh se si qëndron puna.

PJESA E SHTATE
FJALORI

LESSON 53
PART VII.
VOCABULARY

agjencí, -ja	(f.)	agency
agjencí, -t		
i, t'atjeshëm	(adj. m.	of that place
e, t'atjeshme	& f.)	
bankënotë, -a	(f.)	bank note
bankënota, -t		
biletë, -a	(f.)	ticket (bus ticket, etc.)
bileta, -t		
çek, -u	(m.)	check
çeqe, -t		
çeka, -t		
bisedim, -i	(m.)	conversation, discussion
bisedime, -t		
me deklarue	(v.)	to declare
(unë deklaroj)		
dollár, -i	(m.)	dollar
dollarë, -t		
hajde, hajdeni	(interj.)	come, come on
informatë, -a	(f.)	information
informata, -t		
italian, -ë	(adj. m.	Italian
italiane	& f.)	
kabinë, -a	(f.)	cabin; cockpit, telephone booth; cab
kabina, -t		(truck)
kurrsesi	(adv.)	by no means, in no way
me lidhë	(v.)	tie, to connect, link, leash, bind, bandage
(unë lidh)		
málli, -i	(m.)	merchandise, goods; property
malina, -t		
me marrë vesh	(v.)	to understand; to find out
(unë marr vesh)		

LESSON 53

mundësisht	(adv.)	if possible, possibly
me ngarkue (unë ngarkoj)	(v.)	to put in charge, to load
nisje, -a	(f.)	departure
përgjegje, -a përgjegje, -t	(f.)	reply, answer, response
me pranue (unë pranoj)	(v.)	to accept, admit
rahati, -ja	(f.)	comfort, coziness
rezervim, -i rezervime, -t	(m.)	reservation
me rezervue (unë rezervoj)	(v.)	to reserve
shpenzim, -i shpënzime, -t	(m.)	expense, expenditure
tarifë, -a tarifa, -t	(f.)	charge, tariff, price list
turistik, -ë turistike	(adj. m. & f.)	tourist, touristic
udhëtar, -i udhëtarë, -t	(m.)	passenger, traveler
vapor, -i vapore, -t	(m.)	ship (passenger & cargo)

NOTES:

- ndoshta na takon me
pritë Maybe we'll have to wait.
- me zanë deti
(më zë deti) to get seasick
- si sot dy javë exactly two weeks from today

LESSON 54

PART I

PJESA B PARË

USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. Dative replacing possessive adjectives

- a. A më këthehet letra kur nuk i vë pulla?
 Po, tý të këthehet letra kur nuk i vë pulla.
 A i këthehet letra atij kur nuk i vë pulla?
 Po, atij i këthehet letra kur nuk i vë pulla.
 A na këthehet letra né kur nuk i vëmë pulla?
 Po, né na këthehet letra kur nuk i vëmë pulla.
 A u këthehet letra atyne kur nuk i vënë pulla?
 Po, atyne u këthehet letra kur nuk i vënë pulla.
- b. A m'u-këthye mue letra dje?
 Po, tý t'u-këthye letra dje.
 A t'u-këthye tý letra dje?
 Po, mue m'u-këthye letra dje.
 A i u-këthye atij letra dje?
 Po, atij i u-këthye letra dje.
 A na u-këthye né letra dje?
 Po, né na u-këthye letra dje.
 A i u-këthye atyne letra dje?
 Po, atyne i u-këthye letra dje.

Kujt i u-këthye letra?

- unë: Mue m'u-këthye letra.
 ti: Tý t'u-këthye letra.
 ai: Atij i u-këthye letra.
 ajo: Asaj i u-këthye letra.
 na: Né na u-këthye letra.
 ju: Jú ju u-këthye letra.
 ata: Atyne i u-këthye letra.
 ato:

- A i u-këthye letra shokut?
 Po, shokut i u-këthye letra.
 A i u-këthye letra shokëvet?
 Po, shokëvet i u-këthye letra.

LESSON 54

A i u-këthye letra shoqes?
Po, shoqes i u-këthye letra..

A i u-këthye letra shoqevet?
Po, shoqevet i u-këthye letra.

Kujt i u-këthye letra?

- | | |
|-----------|------------------------------|
| motér: | Motrës i u-këthye letra. |
| villá: | Vllait i u-këthye letra. |
| motra: | Motravet i u-këthye letra. |
| villazën: | Vllazënet i u-këthye letra. |
| mik: | Mikut i u-këthye letra. |
| miq: | Miqvet i u-këthye letra. |
| xhajë: | Xhajës i u-këthye letra. |
| xhaja: | Xhajavet i u-këthye letra. |
| ushtár: | Ushtarit i u-këthye letra. |
| ushtarë: | Ushtarëvet i u-këthye letra. |

c.

Kujt do t'i këthehet letra?

- | | |
|---------|--------------------------------|
| Qamil: | Qamilit do t'i këthehet letra. |
| Hysen: | Hysenit do t'i këthehet letra. |
| Hyrije: | Hyrijes do t'i këthehet letra. |
| nâné: | Nânës do t'i këthehet letra. |

d.

Kujt i u-rrit djali?

- | | |
|------|----------------------|
| unë: | Mue m'u-rrit djali. |
| ti: | Tý t'u-rrit djali. |
| ai: | Atij i u-rrit djali. |

LESSON 54

ajo: Asaj i u-rrit djali.
 na: Né na u-rrit djali.
 ju: Jú ju u-rrit djali.
 ata: Atyne i u-rrit djali.
 ato:

Kujt i u-rritén djelmt?

unë: Mue m'u-rritén djelmt.
 ti: Tý t'u-rritén djelmt.
 ai: Atij i u-rritén djelmt.
 ajo: Asaj i u-rritén djelmt.
 na: Né na u-rritén djelmt.
 ju: Jú ju u-rritén djelmt.
 ata: Atyne i u-rritén djelmt.
 ato:

2.

- a. A tē dhemb dhâmbi tash?
Po, mue mē dhemb dhâmbi tash.
- A i dhambin dhâmbét atij?
Po, atij i dhambin dhâmbét.
- A tē dhimti dhâmbi dje?
Po, mue mē dhimti dhâmbi dje.
- A i dhimtén dhâmbét Sadikut dje?
Po, Sadikut i dhimtén dhâmbét dje.
- A i ka dhimtē dhâmbi Sadikut?
Po, Sadikut i ka dhimtē dhâmbi.
- A i kanë dhimtē dhâmbét Sadikut?
Po, Sadikut i kanë dhimtē dhâmbét.
- A do t'i dhambi dhâmbi Sadikut edhe nesér?
Jo, Sadikut nuk do t'i dhambi dhâmbi nesér.
- A do t'i dhambin dhâmbét Sadikut nesér?
Jo, Sadikut nuk do t'i dhambin dhâmbét.

LESSON 54

A i dhemb dhâmbi nânës?
Po, nânës i dhemb dhâmbi.
A i dhemb dhâmbi mësuesit?
Po, mësuesit i dhemb dhâmbi.

Kujt i dhemb dhâmbi?

unë: Mue më dhemb dhâmbi.
ti: Tý të dhemb dhâmbi.
ai, asaj Atij i dhemb dhâmbi.

3. Dative replacing "pér - accusative."

A bletë ju nji sahat pér djalin?
Po, unë e bleva at sahat pér djalin.
A i bletë nji sahat djalit?
Po, unë i bleva nji sahat djalit.
Kujt i bletë ju nji sahat?
Unë i bleva djalit nji sahat.
A i bletë nji pêndë vajzës?
Po, unë i bleva nji pêndë vajzës.
Kujt i bletë ju nji pêndë?
Unë i bleva vajzës nji pêndë.
A u bletë djelmvet nga nji sahat?
Po, unë u bleva djelmvet nga nji sahat.
Cilëve u bletë nga nji sahat?
Unë u bleva djelmvet nga nji sahat.

Kujt i a prûtë karrigën?

villá: Unë i a prûna karrigën villait.
nânë: Unë i a prûna karrigën nânës.
motër: Unë i a prûna karrigën motrës.
kapter: Unë i a prûna karrigën kapterit.
tetár: Unë i a prûna karrigën tetarit.

4. Forming of nouns by infinitive - s.

- A jam tue mësue unë tash?
 Po, ju jeni tue mësue tash.
- A jam unë mësues?
 Po, ju jeni mësues.
- A jam unë mësuesi juej?
 Po, ju jeni mësuesi im.
- A jeni tue nxânë ju tash?
 Po, unë jam tue nxânë tash.
- A jeni ju nxânës?
 Po, unë jam nxânës.
- A jeni ju nxânsi im?
 Po, unë jam nxânsi juej.
- A ka dërgue Hasani nji letér?
 Po, Hasani ka dërgue nji letér.
- A âsht Hasani dërguesi i letrës?
 Po, Hasani âsht dërguesi i letrës.
- A e ka marrë i vilai letrën?
 Po, i vilai e ka marrë letrën.
- A âsht i vilai marrësi i letrës?
 Po, i vilai âsht marrësi i letrës.
- A jam tue përkëthyen unë tash?
 Po, ju jeni tue përkëthyen tash.
- A jam unë përkëthyes?
 Po, ju jeni përkëthyes.
- A e keni shkrue letrën?
 Po, unë e kam shkrue letrën.
- A jeni ju shkruesi i letrës?
 Po, unë jam shkruesi i letrës.

LESSON 54
PART II
DIALOGUE


PJESA E DYTE
DIALOGU

Në Postëtelegrafë


1. Shumë i gjatë rreshti sot! Mezi m'erdhi radha!
2. Dje ka qenë fundi i muejit, d.m.th. ditë pagese. Shumë nëpunës e punëtorë u dërgojnë të holla familjevet.
3. Kam kët pako për të dërgue në Kukës. M'a peshoni, ju lutem!
4. Nuk pranojmë koliposta po mos të jenë lidhë me spagë të trashë.
5. Nuk besoj të shpërthehet; kutija ësht prej kartoni të fortë.
6. Na kemi nji rregullore, Zotni; s'kam ç'të ju bâj.
7. Mirë. Këto dy letra due t'i dërgoj të porosituna.
8. Letrat e porosituna duhet të kenë të shenuen emrin, mbiemin dhe drejtimin e dërguesit.
9. I kam shenue mbrapa zarfit.
10. Më falni! Nuk më shkoi mendja të shikoj mbrapa, 63 lekë secila, 126 lekë gjithësejt.
11. Due edhe nji mandapostë.
12. Për sa të holla dhe n'emën të kujt e doni?
13. Për 1500 lekë dhe emnin e marrësit e kam shkrue në kët pusullë.
14. Urdhëroni! Tash due prej jush 1500 lekë dhe 20 lekë taksë, gjithësejt 1520 lekë.
15. Qe 2000 lekë! Numroni e m'epni kusurin!
16. Tamam. Qe kusurin: 100, 200, 300, 400 e 80 bâjnë 480. Tjetër?
17. Due ca pulla 5-she e 10-she dhe tri kartë-postale.
18. Në sportelin tjetër, në të majtë, shesin pulla e kartëpostale.
19. Po zyra telegrafike, ku ësht?
20. Në sportelin përbâli. Po atje ka edhe formularë për të shkrue telegramë.

LESSON 54

21. Më vjen keq për pakon: më mbeti pa e nisë.
22. Ka kohë; kolipostat nisen mbas 5 orësh.
23. Ju falem nderit. Po këtëhem më vonë, atëherë.
24. Deri n'orën 6 mbasdreke këtu jam. Të mirë u-pafshim!



LESSON 54



LESSON 54
PART II
DIALOGUE

PJESA E DYTË
DIALOGU

At a Post and Telegraph Office

1. The line is too long today! It took a long time (for my turn).
- 2.. Yesterday was the end of the month--payday. Many employees and workers send money to their families.
3. I have this parcel to mail to Kukës. Weigh it please!
4. We don't accept packages unless they are tied with twine.
5. I don't think it will fall apart because it is made of strong cardboard.
6. These are the regulations, sir! I can't help you.
7. All right; I want to register these two letters.
8. A registered letter should have the name and the address of the sender.
9. I have that on the back of the envelope.
10. I am sorry. It didn't occur to me to look on the back, 63 leks each, 126 leks altogether.
11. I want a money order, too.
12. For how much and in whose name?
13. For 1,500 lek and I have written the recipient's name on this slip of paper.
14. Here it is! Now I want 1,500 leks plus 20 leks for the fee, altogether 1,520 leks.
15. Here are 2,000 leks. Count them and give me the change, please.
16. Right! Here is the change, 100, 200, 300, 400 and 80 makes 480. Anything else?
17. I want some five and ten cent stamps, also 3 postcards.
18. They sell stamps and postcards at the other window, to your left.

LESSON 54

19. Where is the telegraph office?
20. At the window across from us. There you will also find forms for writing telegrams.
21. I don't know what to do with my package; I can't send it.
22. You have time enough; parcels go out 5 hours from now.
23. Thank you. Then I will come back later.
24. I'll be here until 6 in the evening. See you!



Pulla të RPS të Shqipnis

IDIOMS WITH AN INDIRECT OBJECT

a. The short pronoun precedes the verb whenever an indirect object is involved or understood as such.
Examples:

Ai më tha (më) se do të vînte.
(He told me he would come.)

Ju tregova (jú) se si ndodhi puna.
(I told you how it happened.)

U shkrova me m'u-përgjegjë.
(I wrote them to answer me.)

There are some instances, in both colloquial and written Albanian, in which the short pronouns më, na and të do not have any indirect object involved or understood. In this case these three particles express the emotion involved better, and if this type of construction is not used, the beauty of expression suffers. Examples:

Nji herë na kishte qenë nji mbret....
(Once upon a time there was a king....)

M'i bâr të fala cilitdo që të pyesi për më.
(Say hello to anyone who knows me.)

Râ nga pema e t'u-bâ copa-copa.
(He fell from the tree and got killed.)

b. Constructions where the indirect object replaces the possessive adjective are of high frequency in Albanian. Examples:

m'erdhi rrâdha instead of erdhi rrâdha
(it's my turn) imë

t'u-rrit djali instead of u-rrit djali
(your son has grown up)

LESSON 54

i vdiq baba instead of vdiq baba i tij
 (his father passed away)

na kanë dalë emnat instead of emnat tonë kanë
 në gazetë
 (our names appeared in the newspaper)

c. In order to add beauty and shorten somewhat the expression, the indirect object often replaces the direct object preceded by the preposition për.
 Examples:

I bleva djalit nji instead of bleva nji sahat
 sahat. për djalin
 (I bought my son a watch)

Të kam gjetë punë instead of kam gjetë punë
 (I found you a për ty job)

AGENT NOUNS ENDING IN -s OR -se

An agent noun, one that indicates a being or a thing that acts, is a very frequent phenomenon in Albanian.

a. Agent nouns derived from participles:

me mësue (to teach)	mësues (teacher)	mësuese (lady teacher)
me nxâne (to learn)	nxânës (student)	nxânce (lady student)
me folë (to speak)	folës (speaker)	folëse (lady speaker)
me çelë (to open)	çelës (opener, key)	
me marrë (to receive)	marrës (receiver)	marrëse (lady recipient)

LESSON 54

Avoid confusing agent nouns with those verbal nouns derived from substituting -ue of the past participle with the suffix -esë. Examples:

me fërgue
(to fry)

fërgesë
(a particular dish with
fried ground meat; any
fried food)

me mbulue
(to cover)

mbulesë
(cover, covering; blanket)

me vonue
(to delay)

vonesë
(delay)

LESSON 54
PART IV
GRAMMAR DRILL

PJESA I KATËRT
USHTRIME GRAMATIKORE

A erdhi radha jote me hŷ në provim?
Po, erdhi radha ime me hŷ në provim.

A t'erdhi radha me hŷ në provim?
Po, m'erdhi radha me hŷ në provim.

A m'erdhi radha me hŷ në provim?
Po, t'erdhi radha me hŷ në provim.

A i erdhi radha me hŷ në provim?
Po, i erdhi radha me hŷ në provim.

A na erdhi radha me hypë n'autobus?
Po, ju erdhi radha me hypë n'autobus.

A u erdhi radha me hypë n'autobus?
Po, u erdhi radha me hypë n'autobus.

A të dhemb kryet shpesh?
Jo, nuk më dhemb kryet shpesh.

Kujt nuk i dhemb kryet shpesh?
Mue nuk më dhemb kryet shpesh.

Çka nuk të dhemb shpesh?
Nuk më dhemb kryet shpesh.

A ju shkoi mendja se do të vijshem sot?

Jo, nuk na shkoi mendja se do të vijshi sot.
Kujt nuk i shkoi mendja se do të vijshem sot?

Në nuk na shkoi mendja se do të vijshi sot.
A të shkoi mendja dje me ardhë me më pâ?

Po, dje më shkoi mendja me ardhë me të pâ.
Kujt i shkoi mendja dje me ardhë me më pâ?

Mue më shkoi mendja dje me ardhë me të pâ.
Kur të shkoi mendja me ardhë me më pâ?

Dje më shkoi mendja me ardhë me të pâ.

A më mbisin shumë të holla në fund të muejit?

Jo, në fund të muejit nuk të mbisin shumë
të holla.

Kujt nuk i mbisin shumë të holla në fund të
muejit?

Të nuk të mbisin shumë të holla në fund të
muejit.

Kur nuk më mbisin shumë të holla?

Në fund të muejit nuk të mbisin shumë të holla.

LESSON 54

A i u-këthye letra mbas katër ditëve?
Po, mbas katër ditëve i u-këthye letra.
Kur i u-këthye letra?
Mbas katër ditëve i u-këthye letra.
Çka i u-këthye mbas katër ditëve?
Mbas katër ditëve i u-këthye letra.

A të rriten flokët shpejt?
Po, mue më rriten flokët shpejt.
Kujt i rriten flokët shpejt?
Mue më rriten flokët shpejt.
Çka të rritet shpejt?
Mue më rriten flokët shpejt.

A m'i peshove valixhet?
Po, t'i peshova valixhet.
Çka bâne ti?
Unë t'i peshova valixhet.
Cilat valixhe peshove?
Unë i peshova valixhet e tua.

2. A bleve nji-sahat për djalin?
Po, bleva nji-sahat për djalin.
A i bleve djalit nji sahat?
Po, i bleva djalit nji sahat.
Çka i bleva unë djalit.
Ti i bleve djalit nji sahat.
Kush i bleu djalit nji sahat?
Ai i bleu djalit nji sahat.
A u blémë na fëmijëve nga nji çantë?
Po, na u blémë fëmijëve nga nji çantë.
Çka u blémë na fëmijëve?
Ju u bletë fëmijëve nga nji çantë.
Cilëve u blenë ata nga nji çantë?
Ata u blenë fëmijëve nga nji çantë.

3. A dini të numroni shqip?
Po, unë dij të numroj shqip.
A mund të numroni mjift shpejt?
Po, mund të numroj mjift shpejt.

LESSON 54

A gjindet shtëpija juej përbáll shtëpis së tij?
Jo, shtëpija ime nuk gjindet përbáll shtëpis
së tij.

Shtëpija e kujt nuk gjindet përbáll shtëpis së
tij?

Shtëpija ime nuk gjindet përbáll shtëpis
së tij.

Çka nuk gjindet përbáll shtëpis së tij?

Shtëpija ime nuk gjindet përbáll shtëpis së tij.

A shesin kartëpostale në zyrën e postës?

Po, në zyrën e postës shesin kartëpostale.

Ku shesin kartëpostale?

Në zyrën e postës shesin kartëpostale.

Çka shesin në zyrën e postës përveç pullavet?

Në zyrën e postës shesin kartëpostale përveç
pullavet.

A është mbiemni im _____?

Po, mbiemni juej është _____.

Si e keni mbiemnin?

Unë e kam mbiemnin _____.

Si e ka ai mbiemnin?

Ai e ka mbiemnin _____.

A rrini në rresht për të hynë në kinema kur ka
shumë njerëz?

Po, kur ka shumë njerëz unë rrrij në rresht
për të hynë në kinema.

Kur rrini në rresht?

Unë rrrij në rresht për të hynë në kinema kur
ka shumë njerëz.

Kush rrri në rresht për të hynë në kinema kur ka
shumë njerëz?

Unë rrrij në rresht për të hynë në kinema kur
ka shumë njerëz.

A duhet shkrue në çdo zarf emni i dërguesit?

Jo, nuk duhet shkrue në çdo zarf emni i
dërguesit.

Emni i kujt nuk duhet shkrue në çdo zarf?

Nuk duhet shkrue emni i dërguesit në çdo zarf.

LESSON 54

Ku nuk duhet shkrue emni i dërguesit?

Nuk duhet shkrue emni i dërguesit në çdo zarf.

A âsht prej kartoni kutija e fjalorit?

Jo, kutija e fjalorit nuk âsht prej kartoni.

Cila kutí nuk âsht prej kartoni?

Kutija e fjalorit nuk âsht prej kartoni.

A keni dërgue ndonjiherë ndonji letër të porositun?

Po, unë kam dërgue disa herë letra të porosituna.

Sa herë keni dërgue letra të porosituna?

Unë kam dërgue disa herë letra të porosituna.

Çka keni dërgue disa herë?

Unë kam dërgue disa herë letra të porosituna.

A lén dielli në lindje?

Po, dielli lén në lindje.

Në ç'drejtim lén dielli?

Dielli lén në lindje.

A e dini drejtimin e Zotni Përmetit?

Jo, nuk e dij drejtimin e Zotni Përmetit.

Kush nuk e dij drejtimin e Zotni Përmetit?

Unë nuk e dij drejtimin e Zotni Përmetit.

Kur kërkoni nji huá nga banka, a duhet të mbushni nji formulár?

Po, kur kërkoj nji huá nga banka, duhet të mbush nji formulár.

Çka duhet të bâni kur kërkoni nji huá nga banka?

Kur kërkoj nji huá nga banka duhet të mbush nji formulár.

Kur duhet të mbushni nji formulár?

Kur kërkoj nji huá nga banka duhet të mbush nji formulár.

A kam shenue në kët pusullë numrin tim të telefonit?

Po, në kët pusullë keni shenue numrin tuej të telefonit.

Çka kam shenue në kët pusullë?

Në kët pusullë keni shenue numrin tuej të telefonit.

Ku e kam shenue numrin tim të telefonit?

Në pusullë e keni shenue numrin tuej të telefonit.

LESSON 54

A gjindet në Shqipni zyra telegrafike në të njâjtën ndërtesë me zyrën e postës?

Po, në Shqipni, zyra telegrafike gjindet në të njâjtën ndërtesë me zyrën e postës.

Cila zyrë gjindet në të njâjtën ndërtesë me zyrën e postës në Shqipni?

Në Shqipni, zyra telegrafike gjindet në të njâjtën ndërtesë me zyrën e postës.

Ku gjinden zyrat telegrafike në Shqipni?

Në Shqipni, zyrat telegrafike gjinden në të njâjtën ndërtesë me zyrën e postës.

A ka secila dritore në kët dhomë gjashtë xama?

Po, secila dritore në kët dhomë ka gjashtë xama.

Sa xama ka secila dritore në kët dhomë?

Secila dritore në kët dhomë ka gjashtë xama.

Cilat dritore kanë gjashtë xama?

Secila dritore në kët dhomë ka gjashtë xama.

A rri hapët sporteli i telegramavevet 24 orë në ditë?

Po, sporteli i telegramavevet rri hapët 24 orë në ditë.

Cili sportel rri hapët 24 orë në ditë?

Sporteli i telegramavevet rri hapët 24 orë në ditë.

Sa orë në ditë rri hapët sporteli i telegramavevet?

Sporteli i telegramavevet rri hapët 24 orë në ditë.

A dërgoni të holla me çek, apor me mandapostë, zakonisht?

Zakonisht, unë dërgoj të holla me mandapostë..

Kush dërgon të holla me mandapostë, zakonisht?

Zakonisht, unë dërgoj të holla me mandapostë.

Çka dërgoni ju, zakonisht, me mandapostë?

Zakonisht, unë dërgoj të holla me mandapostë.

A përdorim spagë për të lidhë pakos?

Po, për të lidhë pakos përdorim spagë.

Çka përdorim për të lidhë pakos?

Për të lidhë pakos përdorim spagë.

Kush përdor spagë për të lidhë pakos?

Të gjithë përdorin spagë për të lidhë pakos.

LESSON 54.

A ka shkolla jonë rregullore?
Po, shkolla jonë ka rregullore.
Cila shkollë ka rregullore?
Shkolla jonë ka rregullore.
Çka ka shkolla jonë?
Shkolla jonë ka rregullore.

Në qoftë se marrësi i nji letre nuk gjindet në drejtim, a i këthehet letra dërguesit?
Po, në qoftë se marrësi i nji letre nuk gjindet në drejtim, letra i këthehet dërguesit.
Kujt i këthehet letra në qoftë se marrësi nuk gjindet në drejtim?
Në qoftë se marrësi i nji letre nuk gjindet në drejtim, letra i këthehet dërguesit.
Kur i këthehet letra dërguesit?
Letra i këthehet dërguesit në qoftë se marrësi i nji letre nuk gjindet në drejtim.

Use "mezi" with the help of the following statements:

Atij i dhemb karba; ecën me shumë vështirësi.
Ai mezi ecën.
Letra e tij lexohet me vështirësi të madhe.
Letra e tij mezi lexohet.
Ata fasin shqip me shumë vështirësi sepse kanë harrue.
Ata mezi fasin shqip.
Dialogu qe shumë i gjatë; gati s'pata kohë me e mbarue.
Mezi e mbarova dialogun.
Gjella s'kishte krypë aspak; e hangra pa qejf.
Mezi e hangra gjellën sepse s'kishte krypë aspak.
Ai ësht shumë i lodhun; qëndron më kambë me vështirësi të madhe.
Ai mezi qëndron më kambë sepse ësht i lodhun.

PJESA E PESTË
COPË LEXIMI

LESSON 54
PART V
READING TEXT

Ca ditë më parë u kishem shkrue prindëvet se, porsa të merrshem rrogën do t'u dërgojshem nji pak o me veshmbathje. Pardje, pra, qe ditë pagese dhe unë, si gjithë nëpunësit tjerë, mora rrogën dhe menjherë dola në pazár për t'u blé ca plaçka prindëvet dhe nji pëndë motrës. Në mbrâmje i futa të gjitha në nji kuti prej kartoni të fortë, e mylla, shkrova drejtimin dhe kështu koliposta qe gati për t'u-dërgue të nesërmen në mëngjes. E dij se ditën mbas pagesës reshtat me njerëz tue pritë janë të gjatë në postë-telegrafë; prandej dje dola heret, me kolipostë nën krah, tue shpresue që të zejshem radhë ndër të parët. Mjerishë, atje gjeta njerëz që kishin dalë edhe më heret se unë dhe m'u-desh me pritë nji gjymës ore. U-mërzita mjaft deri sa m'erdhi radha, por s'pata çka me bâ.

Kur i dhash kolipostën nëpunësit të postës, ai m'a këtheu tue më thâné me njerzi: "Më vjen keq, Zotni. Ju nuk e keni lidhë pakon me spagë të trashë simbas rregullores. Kjo pak, megjithëse është prej kartoni të fortë, mund të shpërthehet. Pregatitnie si duhet dhe binie mbasdreke!" Me pak fjalë, nëpunësi

LESSON 54

nuk m'a pranoi at pako që kishem pregetitë me aq kujdes. Kishem edhe punë tjetra në postë: dërgova dy letra të porosituna, të cilat nëpunësi, para se t'i pranonë, i këqyri me kujdes në se kishem shenue mbi zarf e nin, mbiemnin dhe drejtimin e dërguesit.

Secila më kushtoi 63 lekë. Mandej kërkova nji mandapostë për 1500 lekë. Shenova emnin, mbiemnin dhe drejtimin e marrësit në nji pusullë dhe i a dhash nëpunësit që t'i shkruente mbi mandapostë. Taksa më kushtoi 20 lekë. Pagova me dy bankënota njimijë lekësh; nëpunësi, mbasi i numroi, më dha kusurin: 480 lekë. Po aty mora edhe ca pulla 5-she e 10-she.

Në sportelin që gjindesh në të majtë bleva tri kartëpostale, kurse në sportelin përbâll, ku gjindesh zyra telegrafike, dërgova nji telegram, natyrisht mbasi e shkrova në nji formulâr. Kolipostën e nisa mbasi dola nga puna.

QUESTIONS-PYETJE

1. Çka u kishem shkrue prindëvet ca ditë më parë?
2. Kur do t'u dërgojshem prindëvet nji pako me veshmbathje?
3. Kur që ditë pageset?

LESSON 54

4. Çka bâna unë fardje, si gjithë nëpunësit tjerë?
5. Ku shkova unë, mbasi mora rrögën?
6. Pse dola në pazár?
7. Çka bleva në pazár?
8. Në mbrâmje, u i futa të gjitha plaçkat që bleva?
9. Prej se ishtë kutija me të cilën bâna pakon?
10. Mbasi i futa plaçkat mbrendë, çka bâna?
11. Çka shkrova mbi pako?
12. Kur qe pakoja gati për t'u-dërgue të nesërmen në mëngjes?
13. Qysh janë rreshtat me njerëz tue pritë ditën mbas pagesës?
14. Çka shpresojshem unë kur dola nga shtëpija heret, me pako nën krah?
15. Pse dola heret të nesërmen në mëngjes?
16. Mjerisht, sa njerëz gjeta në postëtelegrafë?
17. Sa kohë m'u-desh me pritë?
18. A u-mërzita deri sa m'erdhi radha?
19. Kush m'a këtheu kolipostën?
20. Qysh m'a këtheu kolipostën nëpunësi i postës?
21. Çka më tha ai me njerzi?
22. Me çka duhet t'a kishem lidhë pakon?
23. Çka thotë rregullorja e postës?
24. Çka i ngján pakos në qoftë se nuk e lidhim me spagë të trashë?

LESSON 54

25. Çka më tha nëpunësi i postës më në fund?
26. Çfarë letrash dërgova në postë?
27. Çka bâni nëpunësi i postës para se me i pranue letrat?
28. Emni, mbiemni dhe drejtimi i kujt duhen shkrue mbi zarfin e nji letre së porositun?
29. Sa më kushtoi secila nga letrat e porosituna?
30. Për sa lekë e kërkova mandapostën?
31. Ku e shenova emnin, mbiemmin dhe drejtimin e marrësit të mandapostës?
32. Sa lekë më kushtoi taksa e mandapostës?
33. Me çfarë bankënotash pagova?
34. Sa kusur më dha nëpunësi?
35. Çka mora po n'at sportel?
36. Çka bieva në sportelin që gjindesh në të majtë?
37. Çka bâna në sportelin përbâlli?
38. Kur e dërgova kolipostën?

PJESA E GJASHTË
DETËRË SHTËPIJE

LESSON 54
PART VI
HOMEWORK

Translate into Albanian:

1. It didn't occur to me to ask him; I forgot.
2. He remained behind because he was very tired.
3. You can send packages with clothing to Albania, but they might have to pay duty.
4. I don't know in what direction he went.
5. Fill in this form and send it to the University of Tirana.

Përkëtheni anglisht këto fjali:

6. Nuk mund të dërgojsh të holla në Shqipnë me mandapostë; duhet t'i dërgojsh me çek.
7. Ka qenë shumë i sëmundë; mezi ecën.
8. Asht kundër rregullores së shkollës të pini ~~u ihu~~ në klasë.
9. E kam shenue diku datën, në të cilën duhet të shkoj ke mjeku, por s'e mbaj mend se ku.
10. Bleva dy këmisha; i dhash njimijëshe, por harroi të m'epte kusurin dhe unë harrova t'i a kérkoj.

PJESA E SHTATE
FJALORI

LESSON 54
PART VII
VOCABULARY

dërgues, -i	(m.)	sender
dërgues, -it		
drejtim, -i	(m.)	address; direction
drejtime, -t		
formular, -i	(m.)	form (to be filled in)
formularë, -t		
kartëpostale,		
kartëpostalja		
kartëpostale, -t	(f.)	postcard
karton, -i	(m.)	cardboard
kartona, -t		
kolipostë, -a	(f.)	parcel, package
koliposta, -t		
kujdes, -i	(m.)	care, attention
kujdese, -t		
kusúr, -i	(m.)	change (balance), (the) leftover, remainder, rest (remainder)
mandapostë, -a	(f.)	money order
mandaposta, -t		
marrës, -i	(m.)	recipient, receiver
marrës, -it		
me mbetë (unë mbes or jes)	(v.)	to remain, stay, to get stuck; to die in a war; to flunk an examination
mbiemën, mbiemni	(m.)	last name;
mbiemna, -t		adjective
mezi	(adv.)	hardly, scarcely, with difficulty

LESSON 54

me nisë (unë nis)	(v.)	to send, to dis- patch; to start
me numrue (unë numroj)	(v.)	to count
me peshue (uné peshoj)	(v.)	to weigh
pérbáll	(adv. & prep.)	opposite, across
i, e, tē porositun tē porosituna	(adj. m. & f.)	registered (mail); instructed
pusullë, -a pusulla, -t	(f.)	slip, note
radhë, -a radhë, -t	(f.)	turn; line, row
rregullore, rregullorja rregullore, -t	(f.)	set of regulations
rresht, -i rreshta, -t	(m.)	line, row
secila	(pron. & adj. f.)	each, every
spagë, -a	(f.)	string
spagë e trashë	(f.)	twine
sportel, -i sportele, -t	(m.)	window (service window)
me shenue (unë shenoj)	(v.)	to mark, brand, to make a note of, to jot down
i, tē shenuem e, tē shenueme	(adj. m. & f.)	indicated, marked; noteworthy
me u-shpérthye (unë shpérthehem)	(v.)	to unbutton; to come apart, to fall to pieces

LESSON 54

telegrafik, -e	(adj. m. & f.)	telegraphic, telegraph
i, e, të trashë të trasha	(adj. m. & f.)	thick, fat; stupid
vështirësi, -ja <u>vështirësi, -</u>	(f.)	difficulty

NOTES:

- s'kam ç'të ju bâj I can't help you.
nuk më shkoi mendja It didn't occur to me.

Përgjegjet e fjalëvet kryq

Faqe 31:

1. Shqipe
2. Tetár
3. Mësim
4. Hapat
5. Burim
6. Zilja
7. Letra

Faqe 151:

1. Bardhë
2. Mendoj
3. Arsye
4. Rakija
5. Ethet
6. Qingji

